



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTER SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

DITARI MUJOR

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

JANAR 2022

Nis puna për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve

Ka nisur puna për hartimin e akteve nënligjore të projektligjit "Për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Startup-eve", i cili pritet të kalojë në Komisionin e Financave dhe Ekonomisë, e më pas në Parlament për t'u miratuar.

Grupi i punës, i ngritur pranë Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, po vijon me konsultimin, mbledhjen dhe reflektimin e të dhënave dhe informacioneve, për fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të hartimit të akteve nënligjore.



Industria automotive / Suksesi i kompanisë "PSZ Albania" dhe "Mabiel"

Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, znj. Edona Bilali, vizitoi kompaninë gjermane "PSZ Albania", e cila prodhon komponentë elektro-mekanikë për sistemet e ngrohjes së automjeteve, si dhe kompaninë italiane "Mabiel", një nga dy prodhuesit kryesorë në botë të fijeve metalike të guarnicioneve të makinave, që prej 5 vitesh ushtron veprimtarinë e saj në Shqipëri.

Bashkëpunim me UNDP-në për zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri

Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, znj. Edona Bilali, bëri me dije se disa biznese suedeze kanë shfaqur interes për të investuar në Shqipëri. Në bashkëpunim me UNDP-në, Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, do të ofrohen programe që sensibilizojnë dhe motivojnë sektorin privat, sidomos atë të manifakturës dhe agro-përpunimit, që të përqafojnë SDG-të (Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm).



Ministrja Edona Bilali takon Ambasadorin e Greqisë, Izraelit dhe Austrisë

Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, znj. Edona Bilali, priti Ambasadorin e Greqisë, znj. Sophia Philippidou, Ambasadorin e Izraelit, z. Noah Gal Gandler, si dhe Ambasadorin e Austrisë, z. Christian Steiner. Ministrja Bilali u shpreh se qëllimi i këtyre takimeve është vijimi i komunikimit dhe bashkëpunimit për ndarjen e praktikave më të mira nga Greqia, Izraeli dhe Austria, për të përshtatur modelin e tyre me Shqipërinë, në fushën e startupeve, inovacionit, biznesit dhe turizmit.